STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 2 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) PARALAJMERON BANORET E NJU JORKUT (NEW YORKERS) NDAJ MASHTRIMEVE TE RIPARIMIT TE SHTEPIVE PAS SENDIT (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) paralajmëroi sot banorët e Nju Jorkut që të mbrojnë veten nga mashtruesit e riparimit të shtëpive, që do të përpiqen të shfrytëzojnë pronarët e shtëpive që nuk kanë dijeni të cilët vuajtën dëm të pasurive nga Stuhia Sendi (Sandy).

"Shumica e njerëzve dhe bizneseve do të punojnë mjaft për të rindërtuar, por trishtueshëm disa njerëz të pandershëm do të përpiqen të shfrytëzojnë fatkeqësinë e të tjerëve për të fituar një dollar të shpejtë, të pandershëm," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Nuk do të dëshironi të shtoni mashtrimin tek dëmi që keni pësuar tashmë nga stuhia. Mund të mbroni veten duke u ruajtur dhe duke marë përkujdesje të thjeshta."

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Departamentit të Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services), tha "Mashtrimi me rindërtimin e shtëpive rritet jashtëzakonisht pas një stuhie të madhe. Eshtë thelbësore që të mbroni veten. Nëse pasuria juaj është dëmtuar, ka të ngjarë të jeni të shqetësuar dhe dëshironi t'i ktheni gjërat përsëri në normalitet sa më shpejt që të jetë e mundur. Mashtruesit e shfrytëzojnë këtë. Prandaj është e rëndësishme që të mendoni për një farë kohe për vendimet, të shihni disa oferta, të keni një kontratë me shkrim dhe thjesht t'i thoni jo gjithshkaje që tingëllon e dyshimtë ose shumë e mirë për të qënë e vërtetë."

Këto janë disa shenja paralajmëruese që ju tregojnë të shmangni një kontraktor ose shitës. Kini kujdes nga kushdo që:

1. Vjen në shtëpinë tuaj ose ju merr në telefon dhe ofron të bëjë riparime.
2. Ju thotë se duhet t'i bëni riparimet menjëherë.
3. Flet shumë shpejt për t'ju hutuar dhe ju bën presion që të nënshkruani një kontratë menjëherë.
4. Ju thotë se janë duke bërë punë në lagjen tuaj dhe se kanë material shtesë të mbetura nga një punë tjetër.
5. Ju ofron një çmim me zbritje ose zbritje nëse i referoni të tjerë, por vetëm nëse blini sot.
6. Ju thotë diçka që tingëllon shumë e mirë për të qënë e vërtetë. Ka të ngjarë të mos jetë e vërtetë!

Albanian

7. Nuk është një biznes i vendosur në vend, por ka ardhur në rajon nga diku gjetkë për të "ndihmuar."

"Eshtë një ide e mirë të diskutoni me familjen tuaj sesi të trajtoni dikë që vjen tek dera juaj për t'ju shitur një riparim të shtëpisë. Nëse të gjithë e dini se ç'farë të bëni, ajo do të ndihmojë në parandalimin e mashtrimit të riparimit të shtëpive," tha Loski (Lawsky).

Përveç kësaj, është e zgjuar të:

- Shmangni kontraktorë të paliçensuar në rajone të Shtetit ku kërkohet një licensë (NYC, Naso (Nassau), Safolk (Suffolk), Putnëm (Putnam), Roklën (Rockland), Uestçester (Westchester)).
- Kontraktorë të paliçensuar janë duke vepruar në mënyrë të paligjshme në ato rajone.
- Shmangni kontraktorë që nuk japin referenca ose referencat e të cilëve nuk mund të kontaktohen.
- Shmangni kontraktorë që ju thonë se nuk ka nevojë për një kontratë më shkrim. Sipas ligjit, të gjitha kontratat për 500 dollarë ose më shumë duhet të jenë me shkrim, por është një ide e mirë të merrni një kontratë me shkrim edhe për projekte më të vogla.
- Shmangni kontraktorët që kanë vetëm një adresë të kutisë postare ose një numër të telefonit celular.
- Shmangni kontraktorët që nuk ju japin një vërtetim të sigurimit.
- Shmangni kontraktorët që ju kërkojnë të merrni lejet e kërkuara të ndërtimit. Ajo mund të nënkuptojë se kontraktori është i paliçensuar ose ka një të histori të keqe dhe prandaj ngurron të merret me inspektorin vendor të ndërtimit. Megjithatë, duhet të verifikoni me departamentin tuaj vendor të ndërtimit se të gjitha lejet e nevojshme janë siguruar nga kontraktori.
- Kini kujdes nga kontraktorë që kërkojnë para për të blerë materialet përpara fillimit të punës. Kontraktorët e besueshëm, të vendosur mund të blejnë materiale me kredi.
- Shmangni kontraktorë që kërkojnë pagesa në para ose dëshirojnë pagesën e plotë paraprakisht, përpara sesa puna të ketë filluar. Përkundrazi, gjeni një kontraktor që do të pranojë një grafik pagesash, duke siguruar për një pagesë fillestare paraprake dhe pagesa të mëpasshme në rritje derisa puna të përfundojë.

"Gjithnjë mbani pagesën përfundimtare derisa të keni përfunduar një kontroll përfundimtar, të keni miratuar të gjithë punën e përfunduar dhe të gjitha inspektimet dhe çertifikatat e nevojshme të strehimit ju janë dorëzuar," tha Kryeinspektori Loski (Lawsky).

Nëse mendoni se keni qënë viktima të një mashtrimi, duhet të këshilloheni menjëherë me një avokat. Ka afate kohore për të anulluar shitjet dhe për të ndjekur pretendime ligjore. Gjithashtu mund të kontaktoni Departamentin e Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) për mashtrimet që kanë lidhje me sigurimet ose prokurorin e qarkut tuaj ose Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme (Attorney General's Office).

Nëse keni një problem me një kontraktor të rinovimit të shtëpisë dhe nuk mund t'a zgjidhni vetë, mund të paraqisni një ankesë pranë Departamentit të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of State) në www.dos.ny.gov ose duke telefonuar në 1-800-697-1220. Gjithashtu mund të ankoheni pranë zyrës tuaj vendore për mbrojtjen e konsumatorit.

Albanian

Konsumatorët duhet të kontaktojnë ndërmarrjen, agjentin ose ndërmjetësin e tyre të sigurimit për të marë përgjigje për pyetje të caktuara në lidhje me policat ose pretendimet e tyre. Konsumatorët që kanë nevojë për ndihmë të mëtejshme duhet të ndjehen të lirë për të kontaktuar me Zyrën e Shërbimeve për Konsumatorët të Departamentit të Shërbimeve Financiare të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of Financial Services' Consumer Services Bureau) në 800-342-3736, i cili funksionon nga 9 në mëngjes deri në 4:30 pasdite, të hënën deri në premten. Vetëm telefonatat në lidhje me katastrofën duhet të shkojnë në linjën për katastrofën në 800-339-1759, e cila është e hapur 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë.

Disa sugjerime për mënyrën e sigurtë për të gjetur një kontraktor që të riparojë shtëpinë tuaj:

- Kontrolloni kontraktorët. A ka reputacion të mirë ndërmarrja? Për sa kohë ka qënë në biznes? Kërkoni referenca dhe pastaj kontrollojini ato. Sigurohuni se ndërmarrja eshte e liçensuar dhe e siguruar. Kërkoni të shihni policën e sigurimit ose çertifikatën e sigurimit të saj. Ka burime në internet për të mësuar në lidhje me përvojën e njerëzve të tjerë më kontraktorët.
- Merrni të paktën dy oferta. Shumë ndërmarrje bëjnë inspektime dhe vlerësime me shkrim falas -- merrni dy ose tre përpara sesa të zgjidhni një kontraktor. Mbani mend se çmimi më i ulët nuk është gjithnjë marrëveshja më e mirë. Krahasoni kostot, materialet dhe metodat e sugjeruara nga ndërmarrje të ndryshme për të vendosur se cilat materiale dhe metoda janë më të mirat për shtëpinë tuaj.
- Këmbëngulni për një kontratë më shkrim që përfshin një përshkrim të hollësishëm të punës që duhet bërë dhe që përcakton saktësisht se cilat materiale do të përdoren dhe cilësinë e tyre. Kontrata duhet të përfshijë datën e fillimit dhe datën e përafërt të përfundimit. Kushtet, përfshirë çmimin, tarifat e financimit dhe të pagesave, duhet të jenë ato për të cilat ratë dakort. Nëse jo, mos e nënshkruani atë! Sigurohuni të merrni një kopje të çdo gjëje që nënshkruani kur e nënshkruani atë.
- Pyesni nëse ka një garanci. Nëse po, sigurohuni se është me shkrim. Nëse ndërmarrja nuk do t'i vendosë premtimet e saj me shkrim, kërkoni një ndërmarrje tjetër e cila do t'a bëjë këtë.
- Mos e nënshkruani kontratën derisa t'a lexoni atë me kujdes. Nëse shitësi ju bën presion që t'a nënshkruani përpara sesa t'a lexoni dhe t'a kuptoni të gjithë kontratën - mos e nënshkruani atë! Mos u mbështesni kurrë tek shitësi që t'ju lexojë ose t'ju shpjegojë kontratën.
- Mos paguani paraprakisht për punën.
- Kontrolloni të gjithë punën me shumë kujdes për t'u siguruar se ishte bërë siç duhet. Nëse keni ndonjë dyshim ose pyetje, MOS bëni pagesën tuaj përfundimtare ose mos nënshkruani një "çertifikate të përfundimit" derisa puna të përfundojë siç duhet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418